

Informohet se avionët ushtarakë të forcave të Asadit sulmuan në qarqet e qytetit Homs e cila është nën kontrollin e opozitës, ku humbën jetën 32 persona dhe u plagosën 200 të tjerë, raporton Anadolu Agency (AA).

Aktivisti i medias lokale në Homs, Samir el Humusi në deklaratën e tij për AA njoftoi se avionët ushtarakë të forcave të Asadit sulmuan në qarkun Telbise ku humbën jetën 16 civilë, në qarkun Rastan 7 dhe Zaferan 9, ndërsa gjithsej janë të plagosur 200 persona.

Humusi theksoi se është duke u bërë identifikimi i atyre të cilët kanë humbur jetën, dhe të plagosurit janë duke u trajtuar në spitalet fushore në qarqet e përmendura.

-Pretendohet se avionët rus e kanë kryer sulmin-

Humusi theksoi se për shkak të shkatërrimit në rajonin e sulmit, qytetarët kanë pretenduar se avionët rus kanë sulmuar në rajonet e qyteteve Homs dhe Hama, ku opozita e mban nën kontroll dhe tha se: "Avionët të cilët sulmuan në këtë rajon ku opozita e mban nën kontroll janë ndryshe nga avionët tjerë. Fuqia shkatërruese e këtyre avionëve është më e madhe se të tjerët. Në dëgjimet që bënin opozita e armatosur mund të vërehet se bisedimet mes avionëve dhe kullës ishin në gjuhën ruse".

Komiteti i Koordinimit Lokal të Sirisë (LCC) gjithashtu konfirmoi se në sulmet që ndodhën në qarqet Rastan, Telbise dhe Zafaran të Homsit kanë humbur jetën dhe janë plagosur shumë civilë.

Theksohet se në rajonet e sulmit ka ndodhur dëm i madh dhe se ekipet e mbrojtjes civile janë duke u përpjekur të arrijnë te mbijetuarit nën rrënojat.